



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net) tel: 0280390112

Rektori: Prof. Dr. Bajram Kosumi Ref.nr. 01/856 Dt. 28/04/2023

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, dhe Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/742 të dt. 28.04.2022 si dhe Vendimi të Senatit të Universitetit në mbledhjen e mbajtur më datë 27.04.2023, merr vendim për të shpallur:

## K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.

1. Një mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike (Programi Bachelor: Shkenca Kompjuterike për këtë grup lëndësh: Programimi I (O), Programimi II (O), Algoritmet/Strukturat e të dhënave (O), Aplikimi i Aproximimeve në AI dhe Robotike (O) dhe programi Master : Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificiale)

2. **Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuara (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Certifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.



Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

- Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL, TOEIC apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregullores Nr.01/742 dt.28.04.2022 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe të universitetit.**

Paraqitja e dokumenteve: Kërkesa protokollohet në zyrën e arkivës nr. 4.

**Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në [info@uni-gjilan.net](mailto:info@uni-gjilan.net) si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.**

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>

